



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 183 Akti

Nr. 216 Vendimi
Tiranë, më 4.12.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Pamela Qirko	Anëtare
Firdes Shuli	Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare Maria Tuma, në datën 04.12.2019 në mjediset e punës së Komisionit mori në shqyrtim mbi bazë dokumentash, çështjen që i përket :

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Agim Bendo**, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligj nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. ***, datë 4.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Agim Bendo, është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), të gjithë prokurorët, i nënshtrohen rivlerësimit, *ex officio*.

2. Në datën 17.9.2018 u hodh shorti në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për trupin gjykues i cili do të kryejë procesin e rivlerësimit të subjektit Agim Bendo. Trupi gjykues i shortuar për këtë qëllim është i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Firdes Shuli, dhe me vendimin nr. 1, datë 24.9.2018, vendosi të fillojë procesin e rivlerësimit për të tri kriteret. Anëtarët e trupës deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

3. Gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit administroi shkresën nr. *** prot., datë 4.11.2019, të KLGJ-së, me të cilën përcillej vendimi nr. ***, datë 4.11.2019, “Për mbarimin e statusit të magjistratit, për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Agim Bendo”, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status. Sipas këtij vendimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kërkesën për dorëheqje nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, e regjistruar me aktin nr. *** prot., datë 4.9.2019, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Agim Bendo. Efektet e këtij vendimi kanë filluar në datën 31.10.2019.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

4. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Agim Bendo, ka nisur në respektim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

5. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, konstaton se:

- Z. Agim Bendo, ka qenë me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

- Procesi i rivlerësimit ndaj tij nuk ka përfunduar me vendim sipas pikës 1, të nenit 58, të ligjit 84/2016.

- Sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës subjekti i rivlerësimit, z. Agim Bendo, ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen.

- Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ky i fundit me vendimin nr. ***, datë 4.11.2019, ka vendosur: (i) deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Agim Bendo, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit; (ii) efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 31.10.2019; (iii) njoftimin e gjyqtarit Agim Bendo sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe publikimin në faqen zyrtare të KLGJ-së; (iv) kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

- Subjekti nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit të KLGJ-së, konfirmuar me shkresën kthim përgjigje Nr. *** Prot, dt.25.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

6. Pika 1, e nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, përcakton: *“Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen....”*

7. Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si më poshtë vijon: *“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”*

8. Neni G, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

9. Në këto kushte, referuar fakteve të konstatuara më lart trupi gjykues çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin Agim Bendo, duhet të ndërpritet sipas nenit G, të Aneksit të Kushtetutës. Në zbatim të nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative, procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t’u dëgjuar, në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji (gërma “d”). Duke qënë se neni G i Aneksit të Kushtetutës, parashikon ndërprerjen në rast dorëheqjeje nga detyra, ndërprerja e procesit duhet të bëhet pa u zhvilluar seanca dëgjimore.

10. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Agim Bendo, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Ndalimin e emërimit të z. Agim Bendo si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 02.12.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ

Kryesuese

Pamela QIRKO

Anëtare

Firdes SHULI

Relatore

Sekretare gjyqësore

Anisa Duka